



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 07, datë 15.03.2018

Për miratimin e metodologjisë për shpërndarjen e shpenzimeve për fondin e sigurimit të depozitave në Shoqëritë e Kursim - Kreditit

Në mbështetje të nenit 52 pika 1, shkronja “ll” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “g/1” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 28, datë 3.11.2014, të ndryshuar, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë metodologjinë për shpërndarjen e shpenzimeve për fondin e sigurimit të depozitave në Shoqëritë e Kursim-Kreditit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar